THIRRJE PËR APLIKIM

Pozita: Drejtor/e Ekzekutiv/e
Afati i aplikimit: 18 korrik 2025
Adresa për aplikim: konkurs.orca@gmail.com

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) shpall të hapur konkursin për pozitën e **Drejtorit/es Ekzekutiv/e**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Udhëheq ORCA-n në përputhje me misionin, strategjinë dhe objektivat e saj.
- Përfaqëson organizatën ndaj institucioneve, partnerëve dhe publikut.
- Menaxhon stafin dhe burimet organizative me integritet dhe transparencë.
- Siguron zbatimin e suksesshëm të strategjisë së ORCA-s 2025–2030.
- Raporton te Bordi Ekzekutiv dhe Kuvendi i Anëtarëve.

Kriteret e përgjithshme për aplikim:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë personat me shtetësi të Kosovës ose të drejtë pune në Kosovë.
- Aftësi të dëshmuara në udhëheqje, menaxhim organizativ dhe/apo drejtim projektesh, së paku 3 vite.
- Njohuri për sektorin e arsimit dhe shoqërisë civile.
- Aftësi të mira komunikimi dhe përfaqësimi.
- Njohuri të mira për menaxhimin financiar dhe burimet njerëzore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Dokument identifikues (letërnjoftim ose pasaportë)
- CV
- Forma e aplikimit
- Letër motivimi
- Ese

Afatet dhe fazat e përzgjedhjes:

- **2 qershor – 18 korrik**: Pranimi i aplikimeve
- **29 gusht**: Vendimi i Bordit Ekzekutiv
- **1 shtator**: Miratimi nga Kuvendi i Anëtarëve dhe publikimi i emrit të Drejtorit /es të/së ri/re
- **15 shtator**: Dorëzimi zyrtar i detyrës dhe fillimi i mandatit të Drejtorit/es të/së zgjedhur

Mënyra e aplikimit:

Aplikimet dërgohen në emailin zyrtar të organizatës:
konkurs.orca@gmail.com

Forma e aplikimit dhe dokumentet shtesë do të publikohen në uebfaqen dhe rrjetet sociale të ORCA-s.

📍 **Shënim:** Vetëm aplikimet e kompletuara dhe të pranuara deri më **18 korrik 2025** në orën 23:59 do të merren parasysh. Organizata siguron konfidencialitet dhe trajtim të barabartë për të gjithë aplikuesit.

📍 **Shënim:** Aplikimet që përmbajnë informacione të pavërteta apo lajthitëse mund të diskualifikohen në çdo fazë të procesit të zgjedhjes.